



SQ

Shenjat e gishtave dhe Eurodac

Informacion për shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi të gjetur që rrinë në mënyrë të paligjshme në një shtet anëtar, sipas nenit 29(3) të rregullores së (BE) nr. 603/2013

Nëse ju gjendeni që rrini në mënyrë të paligjshme në një vend të 'Dublinit' ¹⁾, autoritetet mund t'ju marrin shenjat tuaja të gishtave dhe t'i transmetojnë ato në një bazë të dhënash për shenjat e gishtave të quajtur "Eurodac". Kjo është vetëm me qëllim për të parë nëse ju keni aplikuar më parë për azil. Të dhënat tuaja të shenjave të gishtave nuk do të ruhen në bazën e të dhënave të Eurodac, por nëse ju keni aplikuar më parë për azil në një vend tjetër, ju mund të dërgoheni mbrapsht në atë vend.

Nëse shenjat tuaja të gishtave nuk janë të një cilësie të qartë, përfshirë nëse ju me dashje i keni dëmtuar gishtat, shenjat e gishtave mund t'ju merren përsëri në të ardhmen.

Eurodac operohet nga një Agjensi e Bashkimit European e quajtur eu-LISA. Të dhënat tuaja mund të përdoren vetëm për qëllime të identifikuar nga ligji. Vetëm Sistemi Qendror i Eurodac do të marrë të dhënat tuaja. Nëse ju kërkon azil në të ardhmen në një vend tjetër të Dublinit, shenjat tuaja të gishtave gjithashtu do të merren për t'u transmetuar në Eurodac. Të dhënat e ruajtura në Eurodac nuk do të ndahen me asnjë vend ose organizatë tjetër jashtë BE dhe vendeve të asociuara.

-
- 1) Shtrihet në të gjithë Bashkimin European (Austrinë, Belgjikën, Bullgarinë, Kroacinë, Qipron, Republikën Çeke, Danimarkën, Estoninë, Finlandën, Francën, Gjermaninë, Greqinë, Hungarinë, Irlandën, Italinë, Letoninë, Lituanië, Luksemburgun, Maltën, Hollandën, Poloninë, Portugalinë, Rumannë, Sllovakinë, Slloveninë, Spanjë, Sëedinë, Mbretërinë e Bashkuar) si dhe 4 vendet "e asociuara" me Rregullin e Dublinit (Norvegjinë, Islandën, Zvicrën dhe Litenshteinin).

©Bashkimi European 2014

Autorizohet riprodhimi. Për çdo përdorim ose ri-prodhim të fotove individuale leja duhet kërkuar direkt nga mbajtësit e të drejtës së autorit.

Informacion Kontakti

Mbajtësi i sistemit Eurodac dhe përfaqësuesi i tij

Pikat e kontaktit: Administrata e policisë (Poliisihallitus) dhe Zyra e Migracionit (Maahanmuuttovirasto)

Informacionet e kontaktit të mbajtësit të regjistrit

+ 358 295 480 181
Poliisihallitus (Administrata e policisë)
PL 22, 00521 Helsinki
kirjaamo.poliisihallitus@poliisi.fi

Maahanmuuttovirasto (Zyra e Migracionit)

PL 18, 00581 Helsinki
+358 295 419 600
Numri i shërbimit në këtë lëndë:
+358 295 419 627,
e martë–e enjte ora 10–11
www.migri.fi

Nëse autoritetet tona konsiderojnë se ju mund të keni aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare në një vend i cili mund të jetë përgjegjës për shqyrtimin e atij aplikimi, ju do të merrni informacion më të detajuar rreth procedurës që do të ndiqet dhe sesi ajo ju ndikon ju dhe të drejtat tuaja.

Informacionet e kontaktit të autoritetit zyrtar për ruajtjen e të dhënave personale

Tietosuojaaltuutetun toimisto (Zyra e ombudsmanit për ruajtjen e të dhënave personale)
PL 800, 00521 Helsinki
+ 358 295 666 700
Këshilla me telefon:
+358 295 616 670,
E hënë–e enjte ora 9–11 dhe ora 13–15, e premte ora 9–12
tietosuoja@om.fi
www.tietosuoja.fi





Rajavartiolaitos
Gränsbevakningsväsendet
The Finnish Border Guard